


# PLATFORMË POLITIKASH NGA TË RINJTË E KOMUNËS SË PEJËS

KORRIK - SHTATOR 2017



COPYRIGHT © 2017.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.


Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 34,  
10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PROPOZIM-PLATFORMË POLITIKASH PËR KANDIDATË PËR KRYETAR KOMUNE NË PEJË ME QËLLIM TË ADRESIMIT TË ÇËSHTJEVE TË IDENTIFIKUARA SI PRIORITETE NGA GRUPI JOFORMAL I TË RINJVE

KORRIK - SHTATOR 2017





# PËRMBLEDHJE

Konsolidimi dhe avancimi i qeverisjes së mirë, përveç tjerash kërkon pjesëmarrje aktive të qytetarëve në procesin e bërjes së politikave publike si dhe kërkim llogaridhënies nga politikanët. Pavarësisht mundësive dhe hapësirës që ofron korniza ligjore për pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e bërjes së politikave, sidomos atyre në nivelin komunal, përvoja e deritashme ka dëshmuar që pjesëmarrja mbetet shumë e vogël dhe e kufizuar kryesisht në dy takimet e obligueshme që organizohen brenda vitit me qytetarë. Kjo pjesëmarrje reduktohet edhe më shumë kur bëhet fjalë për të rinjtë, të cilët marrin pjesë në nivele pothuajse të papërfillshme të procesit të bërjes së politikave publike, e në veçanti të politikave që kanë implikime direkte në jetët e tyre.

Marrë parasysh këtë pjesëmarrje kaq të ulët të të rinjve në proceset vendimmarrëse, dhe me qëllim të nxitjes së të rinjve për pjesëmarrje aktive në proces dhe ngritjes së nivelit të përgjegjësisë nga ana e politikanëve, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) është duke zbatuar projektin **“Fuqizimi i votueseve të rinjve për të marrë vendime duke qenë të informuar, dhe duke i ndihmuar**

**ata që t’i mbajnë politikanët llogaridhënës.”** Fillimisht, në kuadër të këtij projekti është zhvilluar një hulumtim i opinionit publik me të rinj të moshave 17 deri 21 vjeç. Të gjeturat kryesore të këtij hulumtimi tregojnë një shpërputhje mes temave të servuara në baza të politikës ditore, dhe temave që realisht preokupojnë të rinjtë. Shqetësimet kryesore të të rinjve konsistojnë në mungesën e perspektivës së punësimit, zhvillimit ekonomik, nivelin e lartë të korrupsionit, gjendjen në sektorin e shëndetësisë dhe liberalizimin e vizave. Kurse, sa i përket institucioneve më të besueshme për të rinjtë, komuna cilësohet si institucioni më i besueshëm dhe vendi i parë ku të rinjtë tentojnë të adresojnë problemet e tyre.

Mungesa e komunikimit me politikanë apo zyrtarë të partive politike është element tjetër që reflektohet në të gjeturat e hulumtimit të opinionit publik. Më konkretisht, rezultatet tregojnë se 80% e të rinjve nuk kanë komunikuar dhe nuk kanë marrë pjesë **asnjëherë** në debate me politikanë apo zyrtarë të partive politike.





Më tutje, në funksion të përmirësimit të nivelit të pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe rritjen e nivelit të përgjegjësisë së politikanëve, KDI ka mbajtur fillimisht shtatë (7) punëtori dy-ditore dhe katër (4) debate publike mes të rinjve dhe të zgjedhurve të tyre. Gjatë punëtorisë për llogaridhënie, rreth 200 pjesëmarrës të rinj u trajnuan lidhur me format moderne të kërkim llogaridhënies, vënien në funksion të vlerave në politikë, sistemet zgjedhore dhe të tjera.

Gjatë debateve publike, është vërejtur se shumica e shqetësimeve të të rinjve janë adresuar për nivelin lokal të qeverisjes. Për këtë arsye, por edhe me qëllim të shtrirjes së kërkim llogaridhënies edhe në nivelin lokal, KDI ka vazhduar me organizimin e punëtorive për politikën e të rinjve, që si synim parësor kanë identifikimin, priorizimin dhe ofrimin e alternativave për problemet e të rinjve. Gjatë muajve qershor dhe korrik, janë mbajtur gjithsej shtatë (7) punëtori, në komunat më të mëdha të vendit: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj dhe Gjakovë.


Grupet e të rinjve të përbërë nga studentë, ndërmar-rës të rinj, përfaqësues të grupimeve rinore të partive politike në nivel lokal, gjatë punëtorive në fjalë kanë identifikuar disa çështje apo probleme që janë të nda-ra në pesë fusha (sektorë) që bien në kompetencë të komunës. Po ashtu, janë ofruar edhe propozime për masat dhe mënyrat si do të mund të adresoheshin nga ana e autoriteteve komunale. Këto probleme dhe ofrimi i masave për zgjidhjen e tyre janë përfshirë në këtë dokument që do të ndahet edhe në formë të platformave politike për kandidatët e mundshëm për kryetar komune në zgjedhjet lokale që do të mbahen në tetor 2017, në secilën nga komunat ku janë mbajtur punëtoritë.



# PROCESI I BËRJES SË POLITIKAVE NË NIVELIN LOKAL

Bazuar në ligjet e aplikueshme (Ligji për Vetëqeverisje lokale), procesi i bërjes së politikave në nivelin komunal është përgjegjësi e Kryetarit të Komunës (ekzekutivi) dhe Asamblesë Komunale (legjislativi). Në praktikë, pjesa më e madhe e këtij procesi inicohet dhe derivohehet nga ekzekutivi, derisa Asambleja rëndom përfshihet në proces të miratimit të politikave (vendime, rregullore) që sillen nga ekzekutivi. Përkundër faktit që me ligjet e aplikueshme komunat janë të pajisura me gamë të gjerë të kompetencave, është evidente që në shumë raste ka mungesë të buxhetit të mjaftueshëm për zbatim të projekteve të planifikuara dhe ofrim të shërbimeve të mira për qytetarët. Për pasojë, autoritetet komunale janë 'të detyruara' shumë herë të prioritojnë dhe zgjedhin çështjet dhe projektet që duhen zbatuar më parë.

Duke pasur parasysh kufizimet buxhetore si dhe problemet që ballafaqojnë komunat në procesin e hartimit të buxheteve komunale, diskutimi dhe puna e grupeve të rinjve është orientuar në identifikimin e çështjeve që janë të prekshme, të zbatueshme dhe që në pjesën më të madhe nuk kanë implikime të mëdha buxhetore. Çështjet e prioritetuara dhe të propozuara në këtë dokument nuk paraqesin një listë me dëshira.





# OBJEKTIVAT

JANË DY OBJEKTIVA QË SYNOHEN  
TË ARRIHEN:

1

Përfshirja e drejtpërdrejtë e të rinjve në procesin e bërjes së politikave publike duke ofruar propozime konkrete për çështjet që kërkojnë zgjidhje. Përfshirja ose jo e këtyre propozimeve nga ana e kandidatëve për kryetar komune në programet e tyre do t'iu shërbej të rinjve si mjet vlerësimi në marrjen e vendimeve të drejta.

2

Intensifikimi i komunikimit ndërmjet kandidatëve të mundshëm për zgjedhje komunale dhe qytetarëve, respektivisht të rinjve në identifikimin e problemeve dhe që diskutimet e përbashkëta me pjesëmarrje aktive qytetare të rrisin cilësinë e jetës së qytetarëve, respektivisht të rinjve.

# Prioritetet e identifikuarra janë:

# 1

## SEKTORI I RINISË



### Problemet e identifikuarra:

Pjesëmarrja e rinisë në procesin e bërjes së politikave është e normuar edhe me ligjet e aplikueshme. Ligji për Fuqizimin e Rinisë, dhe Strategjia për të rinjtë 2013-2017, përcakton qartë rolin dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale kundrejt krijimit të hapësirës për përfshirje të të rinjve në procesin e bërjes së politikave rinore. Strategjia për të rinjtë përcakton objektivat strategjike që synojnë përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje dhe funksionalizimin e avancuar të sektorit të rinisë në nivelin lokal (Neni 3.1 Pjesëmarrja e të rinjve i Strategjisë së Kosovës për të rinjtë 2013-2017).

Në vijim janë identifikuar problemet që kërkohet të adresohen me prioritet nga ana e autoriteteve lokale: Mungesa e strategjisë adekuate nga ana e komunës për përfshirje të të rinjve në aktivitete rinore. Mungesa e implementimit të Udhëzimit Administrativ për punën vullnetare. Mungesa e veprimeve stimuluese nga komuna për të rinjtë që duan të nisin biznese të vogla.




## Masat e propozuara – politika të nevojshme për të adresuar këto probleme:

**1** Ndonëse veprojnë dy qendra rinore dhe hapësira për një qendër të re është në ndërtim, niveli i aktivizimit të të rinjve në aktivitete të ndryshme mbetet shumë i ulët dhe i papërfillshëm. Autoritetet lokale duhet të hartojnë një strategji adekuate e cila synon qasje gjithëpërfshirëse për nxitjen, promovimin dhe angazhimin e të rinjve në aktivitete rinore.

**2** Autoritetet lokale me prioritet duhet të aprovonë rregullore që synon implementimin e Udhëzimit Administrativ për punën vullnetare të nxjerrë në dhjetor të vitit të kaluar.

**3** Autoritetet lokale duhet të gjejnë mënyra për stimulimin e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete vullnetare si: lirim nga pagesa e biletave për teatër, kinema apo bibliotekë të qytetit, pjesëmarrje në aktivitete dhe ngjarje që organizohen nga komuna etj. Autoritetet lokale përfitojnë duke llogaritur gjithmonë në angazhimin e të rinjve vullnetarë në aktivitete me karakter publik. Të rinjtë vullnetarë mund të pajisen me kartela identifikuese dhe do të evidentoheshin në një databazë që do të mirëmbahej nga sektori i rinisë në administratën komunale. Një kompetencë e tillë për regjistrimin dhe koordinimin e aktiviteteve rinore mund t'i jepet një qendre rinore – të rinjtë mund të ndihen më të vlerësuar dhe me më shumë pavarësi në organizimin dhe implementimin e aktiviteteve të tyre.

**4** Autoritetet lokale në bashkëpunim me shkollat profesionale mund të inicojnë një pilot projekt për stimulim të disa bizneseve të vogla që do të fillonin të rinjtë. Stimulimi mund të jetë mos detyrim taksash për një kohë apo edhe me ndonjë mbështetje simbolike financiare në fillim.





# 2

## INFRASTRUKTURË/ PLANIFIKIM URBAN



### Problemet e identifikuara:

Grupi i të rinjve ka identifikuar problemet në vijim që kërkojnë të trajtohen me prioritet nga ana e autoriteteve lokale në fushën e infrastrukturës dhe planifikimit urban: Mungesa e qasjes adekuate për bizneset në Çarshinë e Gjatë paraqet problem serioz për furnizimin e bizneseve që operojnë në atë pjesë. Si pasojë e kësaj, por edhe e mungesës së një parkingu në hapësirat përreth, ka rënie të konsiderueshme të blerësve.

Mosfunksionimi i semaforëve ekzistues, si dhe e shenjave sinjalizuese nëpër rrugë, është po ashtu një problem tjetër që duhet të trajtohet. Grupi i të rinjve ka identifikuar si problem mungesën e tabelave për shpallje publike në më shumë vende në qytet. Parkimi i veturave në trotuare është një problem tjetër por edhe rrezik i vazhdueshëm për qytetarët.



# Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

**1** Të gjitha problemet e identifikuara në këtë fushë mund të zgjidhen lehtë dhe pa implikime të mëdha buxhetore. Mjafton vullneti i mirë nga ana e autoriteteve lokale.

**2** Autoritetet komunale duhet të vendosin shtylla lëvizëse në pjesë të caktuar që do të mundësonin furnizim të dyqaneve në Çarshinë e Gjatë në kohë të caktuar gjatë ditës – mund të aplikohet në orët e hershme të mëngjesit. Nga një zgjidhje e tillë do të përfitonin shumë bizneset në këtë hapësirë pa ndryshuar asgjë në infrastrukturën dhe planin urban dhe gjithsesi pa kosto materiale ose me kosto fare të ulët.

**3** Të shikohet mundësia e identifikimit të një hapësire jo larg Çarshisë për ndërtimin e një parkingu që do të ndikonte drejtpërdrejt në shtimin e blerësve në këtë zonë.

**4** Autoritetet komunale duhet të funksionalizojnë semaforët në zonat ku janë të vendosura në rrugët e qytetit dhe rrjedhimisht të lehtësojnë qarkullimin në trafik ashtu sikur edhe të këmbësorëve. Autoritetet të vendosin shenjat sinjalizuese nëpër rrugë në pjesë të ndryshme ku ato mungojnë.

**5** Grupi i të rinjve ka vlerësuar efektet pozitive të tabelave për shpallje publike që aktualisht janë të vendosura dhe kërkon nga autoritetet lokale të vendosin tabela të tilla në më shumë vende në qytet. Tabelat e tilla ofrojnë mundësi për qytetarët që të njoftohen me zhvillime dhe ndodhi të karakterit publik – kjo gjithsesi paraqet edhe përparësi për autoritetet komunale në ngritjen e transparencës në punën e tyre.

**6** Autoritetet komunale duhet të trajtojnë me prioritet problemin e parkimit të veturave në trotuare. Në bashkëpunim me policinë, një problem i tillë që nuk kërkon fare kosto materiale mund të zgjidhet dhe rrjedhimisht të lehtësohet qarkullimi i këmbësorëve si dhe të mënjanohet rreziku i aksidenteve që potencialisht mund të shkaktohen nga ky problem.





# 3

## SEKTORI I SHËNDETËSISË



### Problemet e identifikuara:

Në fushën e shëndetësisë, grupi i të rinjve ka identifikuar disa probleme që lehtësisht mund të adresohen dhe zgjidhen kryesisht pa implikime buxhetore. Evitimi i problemeve të identifikuara do të ndikoj drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës. Mungesa e barnave esenciale në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe jo rrallë edhe mungesa e materialeve esenciale paraqet problem shumë serioz për qytetarët e

shumtë që trajtimin e tyre e kërkojnë në qendrat e mjekësisë familjare. Problem tjetër është identifikuar edhe mosrespektimi i orarit të punës në këto Qendra, situata të tilla janë më shumë prezente në qendrat që ndodhen në fshatra. Problem tjetër që duhet të trajtohet me prioritetet është edhe mungesa e higjienës në nivelin e duhur në qendra të mjekësisë familjare.




# Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

**1** Qendrat e Mjekësisë Familjare janë institucioni i parë shëndetësor për qytetarët dhe rrjedhimisht duhet të jenë në shërbim të qytetarëve. Autoritetet komunale duhet të trajtojnë me prioritet çështjen e mungesës së barnave esenciale në Qendrat e Mjekësisë Familjare. Është e domosdoshme që autoritetet lokale, në bashkëpunim edhe me ato qendrore të sigurojnë barnat esenciale dhe materialet tjera të nevojshme për qendrat e mjekësisë familjare. Me qëllim të evitimit të mundësive për keqpërdorime eventuale, autoritetet lokale do të mund të aplikojnë një databazë me barnat esenciale dhe materialet tjera që do të menaxhohej rregullisht nga ana e drejtorisë gjegjëse.

**2** Drejtoria komunale e shëndetësisë duhet të rrisë inspektimin e këtyre Qendrave dhe kësaj, pa asnjë kosto materiale, mund të zgjidh problemin e mosrespektimit të orarit të punës që jo rrallë është e shfaqur si dukuri, në veçanti në viset rurale.

**3** Autoritetet komunale, përmes inspektimit të rregullt duhet të adresojnë problemin e mungesës së higjienës në Qendrat e Mjekësisë Familjare. Higjiena nënkupton mirëmbajtjen e ambienteve në këto Qendra ashtu sikur edhe nivelin adekuat të higjienës nga ana e personelit mjekësor. Përveç inspektimit të rregullt, edhe vendosja e kutiave për ankesa për qytetarë mund të shërbejë si një formë presioni pozitiv për stafin punues në Qendra për evitimin e të gjitha problemeve të identifikuara.





# 4

## SEKTORI I ARSIMIT



### Problemet e identifikuara:

Grupi i të rinjve ka identifikuar çështjet në vijim që duhet të trajtohen me prioritet nga ana e autoriteteve lokale me qëllim të përmirësimit të cilësisë në fushën e arsimit: Siguria e dobët në shkolla. Mungesa e bibliotekës së qytetit. Mungesa e infrastrukturës adekuate për qasje të nxënësve me aftësi të kufizuara

në shkolla. Mungesa e psikologëve në shkolla. Mungesa e laboratorëve gjegjës në të gjitha shkollat. Mungesa e digjitalizimit të shkollave. Problemi transportit të nxënësve sidomos në zonat më të thella rurale.



# Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

**1** Autoritetet lokale duhet të trajtojnë me prioritet problemin e sigurisë së dobët nëpër shkolla për të krijuar ambient të sigurt dhe për të evituar incidentet që herë pas here shfaqen. Një siguri më e lartë në shkolla mund të evitohet shfaqjen e dukurive negative të cilat, ndonëse akoma jo në përmasa shqetësuese, tanimë janë prezente dhe mund të kenë pasoja afatgjate për të rinjtë. Problemi i sigurisë në shkolla mund të zgjidhet pa kosto financiare dhe mund të prodhojë efektet e duhura duke ngritur bashkëpunimin në mes të aturoriteve komunale, policisë dhe këshillave të prindërve.

**2** Të zgjidhet me prioritet problemi i mungesës së bibliotekës së qytetit. Me themelimin e universitetit publik në komunë është shtuar edhe më shumë nevoja për bibliotekë me qëllim të krijimit të hapësirës për lexim për nxënës dhe studentë.

**3** Është domosdoshmëri që autoritetet komunale të adresojnë mungesën e infrastrukturës adekuate në objektet shkollore për nxënës me aftësi të kufizuara. Si kategori më vulnerabël meritojnë trajtim me prioritet. Qasja në objekte shkollore është nevojë elementare. Autoritetet lokale të identifikojnë objektet shkollore në të cilat mësojnë fëmijët nga këto kategori dhe që kanë mungesë të infrastrukturës adekuate për nevojat e tyre. Ngjashëm të adresohet edhe mungesa pjerrinave në objektet tjera publike në komunë.

**4** Autoritetet komunale duhet të gjejnë zgjidhje për të siguruar psikolog në shkolla. Ndonëse, sigurimi i tyre për të gjitha shkollat mund të jetë problem, autoritetet të sigurojnë së paku mundësi që së paku një herë në vit nxënësit e klasëve të teta dhe nënta në filllore dhe ata në mësimin e mesëm të komunikojnë me psikolog. Kjo mendohet të ndihmojë në tejkalimin e krizave eventuale që shfaqen tek disa fëmijë zakonisht si pasojë e moshës dhe që potencialisht mund të lënë pasoja tek ta.

**5** Autoritetet komunale duhet të pajisin të gjitha shkollat filllore dhe të mesme me laboratore gjegjëse për lëndët e caktuara me qëllim të rritjes së cilësisë në mësimnxënie. Është kërkesë specifike e grupit të të rinjve që autoritetet lokale të trajtojnë njëjtë edhe shkollat në viset rurale me qëllim të krijimit të kushteve të barabarta për të gjithë nxënësit dhe evitimit të paragjytimeve eventuale për qasje jo të njëjtë. Në të ardhmen, të trajtohet edhe çështja e digitalizimit të shkollave si domosdoshmëri e krijimit të kushteve për nxënës të jenë në hap me kohën.

**6** Autoritetet komunale duhet të gjejnë mënyrë për të siguruar transport për nxënësit nga viset më të largëta e që në raste të caktuara detyrohen të bëjnë rrugë të gjatë deri tek shkollat.



# SEKTORI I AMBIENTIT/ TURIZMI



## ▣ Problemet e identifikuara:

Në sektorin e ambientit dhe turizmit, grupi i të rinjve ka identifikuar problemet në vijim që propozohen të trajtohen me prioritet nga ana e autoriteteve lokale: Mungesa e shportave për mbeturina në gjithë pjesët e qytetit. Puna e dobët e

kompanisë për mbledhje të mbeturinave. Mospastrimi me ujë i rrugëve në qytet. Nevoja për vendosje të hartografive në më shumë pjesë në qytetit. Zyra përgjegjëse për turizëm në komunë jo aktive mjaftueshëm në promovim të turizmit.






# Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:


**1** Autoritetet komunale të adresojnë me prioritet çështjen e mbrojtjes së ambientit. Duhet të vendosen shporta për mbeturina në secilën rrugë të qytetit si dhe të shtohen ato në pjesët më të frekuentuara. Të organizohet një fushatë vetëdijesuese nëpër shkolla me nxënës – kjo të bëhet së paku dy herë në vit për t'i edukuar ata mbi rëndësinë e kujdesit ndaj ambientit ku jetojmë.

**2** Është e domosdoshme që autoritetet komunale të adresojnë problemin e mos operimit të duhur të kompanisë për mbledhje të mbeturinave. Duhet të ngritet niveli i përgjegjësisë së kompanisë gjegjëse por edhe i qytetarëve në faturimin me kohë të borgjeve ndaj kompanisë. Një opsion mund të jetë hyrja në kontratë në mes qytetarëve dhe kompanisë – ata të cilët nuk paguajnë borxhet.

**3** Pastrimi i rrugëve me ujë, sidomos gjatë sezonës verore, duhet të trajtohet si nevojë nga autoritetet komunale – më parë rrugët janë pastruar nganjëherë por tani jo.

**4** Autoritetet komunale duhet të trajtojnë promovimin e turizmit si politikë e nevojshme për komunën tonë. Duhet të vendosen hartografi në më shumë vende në qytet, si dhe zyra gjegjëse komunale duhet të jetë më aktive dhe të ndërmarrë veprime që synojnë promovimin e turizmit në komunën tonë.





## Grupi i të rinjve që kanë kontribuar në hartimin e kësaj propozim-platforme:

ALBINA LLESHI

EGZON AHMETXHEKAJ

LEONORA KRASNIQI

ALDISA MORINA

FLORENTINA PELAJ

RAMË HAJRAJ

BESIANA PËRGJEGJAJ

GENISA FETA

REDŽO KOJIĆ

BLERTA KELMENDI

GENTIANA UKAJ

RREZARTA DAUTAJ

DORONTINA RACI

KALTRINA LAHAJ

ZOJË KRASNIQI

DRILON GASHI


KRISTINA ZIMAJ

ZONJUSHA TOSUA

EDONIS UKSHINAJ

LEART JUSUFI





**Duke pasur parasysh kufizimet  
buxhetore si dhe problemet që  
ballafaqojnë komunat në procesin  
e hartimit të buxheteve komunale,  
diskutimi dhe puna e grupeve të të  
rinjve është orientuar në identifikimin  
e çështjeve që janë të prekshme,  
të zbatueshme dhe që në pjesën  
më të madhe nuk kanë implikime  
të mëdha buxhetore.**

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Projekti është mbështetur nga:



British Embassy  
Pristina